

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PR OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i sallës së Hemodinamikës në Q.S.R.T.,
“Shefqet Ndroqi””

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: Punime ndërtimi,
45210000-2

FONDI LIMIT: 25,852,586.66 (njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e
tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

**KOHEZGJATJA E KONTRATES/MARREVESHJES KUADER OSE AFATI PER ZBATIMIN E
SAJ : 35 ditë**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike ,Relacione , Projektet , Preventivi etj dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor perfituesi cili kërkon realizimin e punimeve.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2/b dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **12,926,293.33** (Dymbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre pikë tre) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **51,705,173.32** (pesëdhjetë e një milion e shtatëqind e pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pikë tre) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë Sipërmarrje

- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
- Aktin e kolaudit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- 1.1** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.2** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohej që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **12,926,293.33** (Dymbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre pikë tre) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **51,705,173.32** (pesëdhjetë e një milion e shtatëqind e pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pikë tre) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (a-b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e

punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave a dhe b, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si**

dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-3 B** Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-1A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-2A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- **NS-4A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-12A** Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit
- **NS-14A** Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-3 B	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.	Betonimi i Shtresës së dyshemese (Sipas nevojës) sipas Specifikimeve Teknike dhe Projektimit të Detajuar. Në përlllogaritje do të përfshihen dhe Steam Barrier th=0.25 mm (Polietilen Foil Pled) dhe fibra xhami. Autonivelant me bazë lidhëse speciale hidroizoluese për dysheme rezistente ndaj gërryerjes përafërsisht. th=3 mm sipas Manualit të Prodhuesit, Specifikimeve Teknike dhe Dizajnit të Detajuar.	B (21-50 milionë lekë)

		F.V Vinil konduktiv homogjen (Conductiv) $th=2$ mm ,me ngjitës konduktiv dhe fiksimi i nënshtresës së rrjetës së brezit të bakrit për testimin e përçueshmërisë speciale sipas Manualit të Prodhuesit, Specifikimeve Teknike dhe Dizajnit të Detajuar. Në përlogaritje do të përfshihet perimetrali i mu F.V Vinil Homogjen, $th=2$ mm me peshë 2.8 Kg/m^2 sipas Manualit të Prodhuesit, Specifikimeve Teknike dhe Dizajnit të Detajuar. Në llogaritje që do të përfshihet dhe perimetrali e murit; (Vinil i lartë 100 mm me kapak fundor) në të gjithë perimetrin e Mureve. F.V veshje e mureve ndarëse mbrojtëse me plumb - Pllakë e sigurt / karton gipsi - Bërthama gipsi e lyer me ngjyrë të verdhë me sulfat bariumi të shtuar ose ekuivalent, kornizë metalike e vetme me dy shtresa. Veshje - e bërë nga min; ($2 \times$ Shtresë gipsi $\times 13$ mm + Lesh guri $d=8$ cm 40 kg/m^3), + flete F.V I mureve ndarëse mbrojtëse me plumb - Pllakë e sigurt / karton gipsi - Bërthama gipsi e lyer me ngjyrë të verdhë me sulfat bariumi të shtuar ose ekuivalent, kornizë metalike e vetme me dy shtresa. Muri - i bërë nga min; $2 \times (2 \times \text{Shtresë gipsi } \times 13 \text{ mm} + \text{Lesh guri } d=8 \text{ cm } 40 \text{ kg/m}^3)$, + flete plumb F.V I tavanit të varur me fibra, i bërë nga tavane me proporcion të mirë me sipërfaqe me mikro-perforim që ofrojnë thithje shumë të mirë të zërit. Mburoja përbëhet nga 1-shtresa $\times 15$ mm 60×60 cm, pllakë tavani akustike me fibra minerale 36 dB, mbrojtje nga zjarri deri në 90 minuta në përputhje me F.V I tavanit të varur me fibra, i bërë nga tavane me proporcion të mirë me sipërfaqe me mikro-perforim që ofrojnë thithje shumë të mirë të zërit. Mburoja përbëhet nga 1-shtresa $\times 15$ mm 60×60 cm, + flete plumbi trashesia 2 mm ekuivalent pllakë tavani akustike me fibra minerale 36 dB, mbrojtje nga z F.V Mure Ndarëse - sipas DIN 4102-3, pa ngarkesë, si ndarje muri drywall. Kornizë e vetme metalike me dy shtresa. Mur sanduic - i bërë nga $2 \times (2 \times \text{Shtresë gipsi } \times 12.5 \text{ mm} + \text{Lesh guri, } d= 5 \text{ cm, } 40 \text{ kg/m}^3)$, izolim zëri sipas DIN 4109 R_w, R në $\text{dB } 50/ 55$. Në llogaritje do të përfshihen të gjitha profil F.V Dyer të plumbuara çelikut, fletë çeliku, të lidhur plotësisht, mbushje leshi guri sipas Manualit të Instalimit të Prodhuesit, Specifikimeve Teknike dhe Dizajnit të orarit të dyerve dhe dritareve. Në përlogaritje duhet të përfshihen të gjithë elementët e fiksimit, doreza, shufrat shtytëse-md1 F.V Mbrojtje Rrezatimi - Derë me rreze X e prodhuar nga Korniza Plumbi - Çelik inox AISI 304 - , Dendësia=50 Kg/m^2 , Pllakë; Pllaka plumbi $th=2,0$ mm siguron që dera të bllokojë në mënyrë efektive rrezatimin me rreze X, sipas Manualit të Instalimit të Prodhuesit, - 160×220 F.V Mbrojtje Rrezatimi - Derë me rreze X e prodhuar nga Korniza Plumbi - Çelik inox AISI 304 - , Dendësia=50 Kg/m^2 , Pllakë; Pllaka plumbi $th=2,0$ mm siguron që dera të bllokojë në mënyrë efektive rrezatimin me rreze X, sipas Manualit të Instalimit të Prodhuesit, - 140×200 F.V Mbrojtje nga Rrezatimi - Dritare me Plumb / Dritare me rreze X e prodhuar nga Korniza Plumbi - Alumini i anodizuar i ekstruduar - Dimensionet; Pllakë 45×63 mm; Xhami i laminuar me plumb $th=10$ mm - (Xhami me rreze	
--	--	--	--

		X, Xhami mbrojtës nga rrezatimi, Xhami me plumb) - 195X155 Heqje dyer ekzistuese Heqje dritare ekzistuese Prishje mur tulle me pastrim Prishje shtrese lluster-çimento dysHEMEJE Prishje suvatim muri i brendshëm Heqje pllaka dysHEMEJE Shtrese me pllaka porcelanat Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25 Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Boje hidroplastike cilesi e larte FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 F.V WC allafrenga F.V lavaman porcelani F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur etj	
NS-1A	Punime për prishjen e ndërtimeve.	Prishje mur tulle me pastrim Prishje shtrese lluster-çimento dysHEMEJE Prishje suvatim muri i brendshëm Heqje dyer ekzistuese Heqje dritare ekzistuese Heqje pllaka dysHEMEJE Prishja e instalimeve ekzistuese: instalimet elektrike, instalimet mekanike dhe instalimet hidraulike dhe transportimi i materialeve të prishura në venddepozitimin e autorizuar. Pastrim i përgjithshëm i sipërfaqeve pas punimeve të prishjes etj.	A (0- 20 milionë lekë)
NS-2A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 F.V WC allafrenga F.V lavaman porcelani "F.V Kolektor per shperndarjen e Ujit Sanitar me Hyrje, 3/4"" me (3+2) dalje x 1/2"" I kompletuar me te gjithë aksesoret buketonë, saracineska kendore me hollandez, tapa bronzi fundore 3/4"" dhe kasetë kolektori dhe tapa prove 1/2"" F.V Lavaman Inoksi per perdorim spitalor grup mishelatori per perdorim me kembe ne dysHEME. F.V Boiler elektrik 60 litersh. F.V Tubo shkarkimi per ujrë e zeza dhe te bardha dhe pershtatja me linjat e shkarkimit egzistuese. etj	A (0-20 milionë lekë)
NS-4A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Shtrese me pllaka porcelanat Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25 F.V veshje e mureve ndarëse mbrojtëse me plumb - Pllakë e sigurt / karton gipsi - Bërthama gipsi e lyer me ngjyrë të verdhë me sulfat bariumi të shtuar ose ekuivalent, kornizë metalike e vetme me dy shtresa. Veshje - e bërë nga min; (2 x Shtresë gipsi x13 mm + Lesh guri d=8 cm 40 kg/m ³), + flete F.V I mureve ndarëse mbrojtëse me plumb - Pllakë e sigurt / karton gipsi - Bërthama gipsi e lyer me ngjyrë të verdhë me sulfat bariumi të shtuar ose ekuivalent, kornizë metalike e vetme me dy shtresa. Muri - i bërë nga min; 2	A (0- 20 milionë lekë)

		x (2 x Shtresë gipsi x13 mm + Lesh guri d=8 cm 40 kg/m³), + flete plumb F.V I tavanit të varur me fibra, i bërë nga tavane me proporcion të mirë me sipërfaqe me mikro-perforim që ofrojnë thithje shumë të mirë të zërit. Mburoja përbëhet nga 1-shtresa x15 mm 60 x 60 cm, pllakë tavani akustike me fibra minerale 36 dB, mbrojtje nga zjarri deri në 90 minuta në përputhje me F.V I tavanit të varur me fibra, i bërë nga tavane me proporcion të mirë me sipërfaqe me mikro-perforim që ofrojnë thithje shumë të mirë të zërit. Mburoja përbëhet nga 1-shtresa x15 mm 60 x 60 cm, + flete plumbi trashesia 2mm ekuivalent pllakë tavani akustike me fibra minerale 36 dB, mbrojtje nga z F.V Mure Ndarëse - sipas DIN 4102-3, pa ngarkesë, si ndarje muri drywall. Kornizë e vetme metalike me dy shtresa. Mur sanduic - i bërë nga 2 x (2 x Shtresë gipsi x12.5mm + Lesh guri, d= 5 cm, 40 kg/m³), izolim zëri sipas DIN 4109 Rw,R në dB 50/ 55 . Në llogaritje do të përfshihen të gjitha profil F.V Dyer të plumbuara çelikut, fletë çeliku, të lidhur plotësisht, mbushje leshi guri sipas Manualit të Instalimit të Prodhuesit, Specifikimeve Teknike dhe Dizajnit të orarit të dyerve dhe dritareve. Në përllogaritje duhet të përfshihen të gjithë elementët e fiksimit, doreza, shufrat shtytëse-md1 F.V Mbrojtje Rrezatimi - Derë me rreze X e prodhuar nga Korniza Plumbi - Çelik inox AISI 304 - , Dendësia=50Kg/m² , Pllakë; Pllaka plumbi th=2,0 mm siguron që dera të bllokojë në mënyrë efektive rrezatimin me rreze X, sipas Manualit të Instalimit të Prodhuesit, - 160X220 F.V Mbrojtje Rrezatimi - Derë me rreze X e prodhuar nga Korniza Plumbi - Çelik inox AISI 304 - , Dendësia=50Kg/m² , Pllakë; Pllaka plumbi th=2,0 mm siguron që dera të bllokojë në mënyrë efektive rrezatimin me rreze X, sipas Manualit të Instalimit të Prodhuesit, - 140X200 F.V Mbrojtje nga Rrezatimi - Dritare me Plumb / Dritare me rreze X e prodhuar nga Korniza Plumbi - Alumini i anodizuar i ekstruduar - Dimensionet; Pllakë 45 x 63 mm; Xhami i laminuar me plumb th=10 mm - (Xhami me rreze X, Xhami mbrojtës nga rrezatimi, Xhami me plumb) - 195X155 Boje hidroplastike cilesi e larte etj	
NS-12A	Impiante teknologjik , termik dhe te kondicionimit	"F.V Kondicionimi MonoSplit Klasa e efikasitetit të energjisë Ftohje/ngrohje: A++/A+ Kapaciteti i ngrohjes: 0.8/4.0/6.5 kW Kapaciteti ftohës: 0.9/3.5/4.5 kW Njësia e brendshme e nivelit të presionit të zërit: 41/17 d B(A) Lloji i ftohësit: R32 Lidhjet e tubave (Lëng + Gaz): 1/4" + 3/8" Tensioni n "F.V Kondicionimi MonoSplit Klasa e efikasitetit të energjisë Ftohje/ngrohje: A++/A+ Kapaciteti i ngrohjes: 2.2/6.0/11.0 kW Kapaciteti ftohës: 2.4/5.0/7.5 kW Njësia e brendshme e nivelit të presionit të zërit: 42/25 d B(A) Lloji i ftohësit: R32 Lidhjet e tubave (Lëng + Gaz): 1/4" + 1/2" Tensioni n "F.V Ventilator Centifugal V=200-550 m³/h Presion statik 130 Pa Fuqia elektrike 40 W Max. Air temp . (°C @ 50Hz) -20/+60" F.V Konstruktion per fiksimin e ventilatorit F.V Potenciometer per kontrollin e shpjetesive te ventilatorit	A (0-20 milionë lekë)

		F.V Kanale ajri prej alumini me spesor 0.5... 1.0 mm per dhome CT Skaneri. Izolimi I kanaleve me veshje termoizoluese "Armacell" me spesor 9mm "F.V Difuzor ajri per dhenie dhe marje ajri Volumi I ajrit: V=350 m³/h Dimensioni imgrilave: 300x300 mm Shpejtesia: Vef=2.5 m/s" F.V Plenumet per difuzoret F.V Tub PEX/al, (Ø16 x 2.0) mm dhe rakorderi, i termoizoluar δ= 6mm etj	
NS-14A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	F.V Paneli LED IP54 është një gamë panelesh LED të integruara për aplikime të përgjithshme të ndriçimit të brendshëm. 32W 4100lm. Maks. rryma e drejtim: 165 mA; Maks. fuqia: 35 W; Jetëgjatësia mesatare: 100 000 orë; 4000 mijë; CRI 80; Efikasiteti deri në: 127Lm/W; Lumeni i fiksimit deri në: 4450lm F. V Ndriçuesi i emrgjences. Në përputhje me ISO7010. Distanca e shikimit 26m. Ngjyra e bardhë e shtëpisë. Mbajtja e funksionimit të urgjencës 3 orë me bateri të rikarikueshme NiMH. Periudha e rimbushjes 24 orë. 2.2W, IK03, IP20. Faktori i fuqisë 0.6. Konstruksioni elektrik i klasit II. F.V Dritë sinjalizuese, me ngjyrë të gjelbër dhe të kuqe. F.V Çelësi alternativ i ndriçimit antibakterial F.V Ndërprerës antibakterial i ndriçimit në një drejtim F.V Kabllo FG16M16 0.6/1kV me seksion 3x2.5 mm². "F.V Paneli i alarmit të zjarrit Concencional, i disponueshëm me 2 unaza, me karakteristika: Tensioni i furnizimit 230V AC 50 Hz (2A me siguresë xhami të mbrojtur) Transformatori 2 x (12V 7Ah) Kapaciteti i Zonës 2, 4, 8, 16 Tensioni i daljes së zonës 24 V DC Rezistenca në fund të zonës 6K8 Pesha ~ "F.V Detektor konvencional të tymit, me karakteristika: Tensioni i furnizimit 10V-30V DC Burimi i zbulimit Dhoma optike Rryma qetësuese (maksimumi) 95 µA Rryma e alarmit (maksimumi) 40 mA Dalja e treguesit në distancë (maksimumi) 45 mA Treguesi i telekomandës MG-4000 Treguesi i alarmit 2 LED të kuq "F.V Pulsanti i thirrjes manuale konvencionale, me karakteristika: Tensioni i funksionimit: 10 - 30 V DC Rryma qetësuese / Alarmi: 0A / 60 mA max. Klasa e mbrojtjes IP: IP22D Ngjyra: E kuqe Pesha: 140 gr Dimensioni: 87 x 91 x 58 mm" "F.V Sirena 87dB, me karakteristika: Tension furnizimi 21-28V DC Rryma e alarmit (maksimumi) 11 mA Fuqia (maksimumi) 0,30 W Përkufizimet e vëllimit Vëllimi i zërit @1m (ton 20) Vëllimi i lartë i zërit: 100 dB(A) Volumi i ulët i zërit: 90 dB(A) Sasia e toneve 32 Përkufizime mekanike PC ndërtimi +ABS F.V Kabllo J-Y(ST)Y 2x0.8mm² F.V Priza antibakteriale, 2M 2P+T, 10-16A së bashku me elementët shoqërues (kuti, mbajtëse dhe pllaka të bardha dekorative) F.V Priza së internetit, RJ-45 së bashku me elementët shoqërues. F.V Switch 16 PoE (USW 16 PoE) është një ndërprerës i menaxhuar plotësisht me (16) porta GbE RJ45, duke përfshirë (8) porte GbE, 802.3at PoE+ dhe (2) porte 1G SFP. USW 16 PoE i gjithanshëm ofron lidhje Gigabit PoE me pajisjet Ethernet, ndërsa ofron gjithashtu opsione të lidhjes së fibrave Gigabit të Furnizimi dhe montimi i stacionit emergjent, me karakteristika: 7.5A, 24V AC. F.V Kanalina metalike 160x75	A (0- 20 milionë lekë)

		F. V Kabllo FG16M16 0.6/1kV me seksion 3x2.5 mm ² . F. V Kabllo FG16M16 0.6/1kV me seksion 5x2.5 mm ² . F.V Kabllo FTP cat6. F.V Kabllot e furnizimit për UPS FG16OM16 (3x95+N1x120+PE1x50)mm ² Kabllo furnizimi për pajisje FG16OM16 0.6/1kV 5x50mm ² . F.V Boks për lidhjen e fuqisë kryesore e kompletuar me automat kontrolli F.V Morsete Elektrode tokezimi ZN (shufer Zn) F.V Morsete Suport shufer M6 etj	
--	--	---	--

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë

të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër

publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP3,NS1,NS4**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS2** eshte e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Hidroteknik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS12** eshte e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Mekanik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS14** eshte e nevojshme prezencat **një Inxhinieri Elektrik**.

2.3.5 Një punësim minimalisht prej 30 (tridhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3** muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per **3** muajt e fundit te deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe

përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosija e kriterit për një punësim të paktën **30** punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ *Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”. Bazuar në këto elementet e struktura të kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore)

Në mënyrë të përmblendhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min **30 punonjës**.

- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Hidraulik	1
Elektricitist	2
Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje	2
Suvatues	2
Pllakashtrues	2
Specialist gipsi	2
Bojaxhi	2
Shofer	1

2.3.6/1 Për punonjësit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve

Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga organe kompetente .

Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Bazuar në kriteret elementare të strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohej në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës "Ekspert në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese" në përputhje Ligjin nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" i ndryshuar, VKM nr. 10, datë 07.01.2010 "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese' i ndryshuar si dhe të figurojë në listat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Punë të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit të përmblidhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për "Ekspert në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese" është vendosur sipas përcaktimeve të të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c" si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" i ndryshuar, VKM nr. 10, datë 07.01.2010 "Për miratimin e rregullores 'Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese' i ndryshuar.

Duke u bazuar natyra e kontratës , kërkesa e projektuesit kërkojmë një Ekspert në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese për të zgjidhur çështje që lidhen identifikimin e burimeve të rrezatimit jonizues ,vlerësimin e rrezikut për njerëzit dhe mjedisin ,zbatimin e masave të mbrojtjes për të kufizuar ekspozimin, vlerëson nivelin e rrezatimit që do prodhojë pajisja hemodinamike ,kontrollon ,muret ,dyert ,tavanin,

,dyshtimë, dhe siguron që ambientet përreth (zyra, korridore,) të mos rrezikohen ,verifikon që masat mbrojtëse të projektuara po zbatohen saktë, kontrollon materialet (plumb, panele, veshje), kryen matje reale të rrezatimit,konfirmon që dozat janë brenda kufijve ligjorë,

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me punimet e parashikuara si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës dhe pas punës.

Për sa më lart, punonjësit e kerkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.8 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes/materialeve	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	F.V Vinil Homogjen, th=2 mm me peshë 2.8 Kg/m ² sipas Manualit të Prodhuesit, Specifikimeve Teknike dhe Dizajnit të Detajuar. Në llogaritje që do të përfshihet dhe perimetrali e murit; (Vinil i lartë 100 mm me kapak fundor) në të gjithë perimetrin e Mureve.		
2	F.V Dyer të plumbuara çelikut, fletë çeliku, të lidhur plotësisht, mbushje leshe guri sipas Manualit të Instalimit të Prodhuesit, Specifikimeve Teknike dhe Dizajnit të orarit të dyerve dhe dritareve. Në përlllogaritje duhet të përfshihen të gjithë elementët e fiksimit, doreza, shufrat shtytëse-md1		
3	F.V Mbrojtje nga Rrezatimi - Dritare me Plumb / Dritare me rreze X e prodhuar nga Korniza Plumbi - Alumini i anodizuar i ekstruduar - Dimensionet; Pllakë 45 x 63 mm; Xhami i laminuar me plumb th=10 mm - (Xhami me rreze X, Xhami mbrojtës nga rrezatimi, Xhami me plumb) - 195X155		
4	F.V veshje e mureve ndarëse mbrojtëse me plumb - Pllakë e sigurt / karton gipsi - Bërthama gipsi e lyer me ngjyrë të verdhë me sulfat bariumi të shtuar ose ekuivalent, kornizë metalike e vetme me		

	dy shtresa. Veshje - e bërë nga min; (2 x Shtresë gipsi x13 mm + Lesh guri d=8 cm 40 kg/m ³), + flete		
--	--	--	--

2.3.8/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.8, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori i autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

2.3.8/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet/materialet sipas pikës 2.3.8, Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjeve/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventiv. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rendesia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që në këtë fazë krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi në këtë mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të këtyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazës së zbatimit në referencë me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nepermjet dorezimit të këtij dokumentacioni që në fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizojë të njëjtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me qëllim që të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion

ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI/ISO **9001-2015 e përditësuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI/ **ISO 14001-2015 e përditësuar** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI/ISO **45001:2018 e përditësuar**, (SSH/DIN/EN/UNI/ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.8 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar

i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 / ekuivalente ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 / ekuivalente është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 ose me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.8 gërma “a”- “c”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Vinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Depozite uji min ne 1000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Trapan	copë	1	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) leje lundrimi për Dragen c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); ç) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje lundrimi për Dragen c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, relacionet, specifikimet etj. bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qendror blerës nga Autoriteti Kontraktor përfitues dhe të hartuara nga projektuesi.

NJESIA E PROKURIMIT